



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	59-02
Nr. i Faqeve No. Pages	04
Nr. i Prot. Prot. No.	4022-2/25
Data: Date:	25.09.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	19.09.2025
REFERENC-Ë:	Nr. Prot. 4022/25 - ZSP 2025 ; ARPL
PËR/ZA/TO:	„MORINA-1 ” Zid i Sadik Ages, K. Gjakovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së; Z. Fatos QERIMI, Drejtori ARPL-së; Z. Fidan BILALLI U.D. Udhëheqës i Divisionit të Akteve dhe Financave
NGA/OD/FROM:	Muhamed MELEQI, Zyrtar i Lartë për Leje Ujore Shfrytëzim të Ujit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me nr. të protok., 4022/25 nga pala, “MORINA-1” Sh.p.k., K. Gjakovë, për shfrytëzim të ujit për betonjerë dhe ka vendosur si në Vendim, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planinng and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. L.U.

Datë: 19.09.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „MORINA-1” me nr prot. 4022/25, datë 20.05.2025, Zid i Sadik Ages, K. Gjakovë, për shfrytëzimin e ujit nga Kanali i ujitjes për betonjerë, nga gypsjellësi TM –V- GY P AC Ø 125 të K.R.U. “Radoniqi Dukagjini” sipas kushteve vijuese:

1. Shfrytëzimi i ujit të bëhet nga kanali i ujitjes, të menaxhuar nga K.R.U. “Radoniqi - Dukagjini “ Sh.a., në parcelen kadastrale, P-70705070 – 00169-8, Z. K. Zid i Sadik Ages, K. Gjakovë, në pikën me koordinata: (X=7 457 065; Y= 4 690 979.377); sipas Dokumentacionit të dorëzuar Tekniko –Investiv,
2. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m³/ditë), dhe sasinë vjetore (m³/vit);
3. Për sasinë e shfrytëzuara pala obligohet, që për çdo gjashtë muaj, të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;



4. Nr. Serik i ujëmatësit, duhet prezantuar në ARPL/MMPHI, brënda 15 dite dhe i njejti nuk mund të ndryshohet, për ndërrimin e mundshëm të tijë duhet informuar Organi përgjegjës që e ka lëshuar këtë vendim;
5. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
6. Për këtë pala obligohet të raportoj shfrytëzimin, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
7. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
8. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit, të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
9. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
10. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon, në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: “Dokumentacioni tekniko – Investiv i të ujit nga Betonjera te Zidi i Sadik Ages” Leje për aktivitete të veçanta, nga komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale, Certifikat e Pronesisë P-70705070-00169-8; Kopja e Planit për njësinë kadastrale P-70705070-00169-8; Plani i situacionit, në përpjesë 1:1000, ashtu siq këkohet në “Udh.Administrativ 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore”, punuar, hartuar nga person i licencuar i lëmisë përkatëse “GEO – KAD” Gjakovë; Analiza e ujit nga Kompania Rajonale e ujësellësit, K. Gjakovë; Kontrata për shfrytëzimin e ujit teknik, me nr. protok.833, datë 08.08.2023 në mes të Kompanisë Regjionale e Ujitjes “Radoniqi Dukagjini” Sh.a dhe “Morina-1” sh.p.k. Gjakovë, me pronar Ilaz MORINA, si marrës i shërbimeve, ne vendi e quajtur “Xeni”, Magjistrallja Gjakovë-Prizren, ne gypsijellësin TM –V- GY P AC Ø 125 mm për sezonin veror, nga muaji Maj gjërë në Shtator; Pëlqimin mjedisor, me Nr. 24/4371/MMPHI, datë 18.12.2024; Pëlqim për zhvillimin e veprimtarisë, 09/11/2023, nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik; Pala sipas dokumentacionit të dorëzuar, ka llogaritur ujin e nevojshëm për përdorim gjatë procesit teknologjik, të pastrimit dhe atë sanitar, gjë që duhet ti permbahet kesaj; Llogartija e prutjes së pranueshme ekologjike; Qertifikata e regjistrimit të biznesit (810867715) “F&K”, Sh.p.k. ; Pagesat për aplikim nr. 00367 nr. 001420; nr. 001421; CD-në. Etj.



Andaj bazuar në kërkesën e palës, bazuar në shikimin në vend, me datë 05.03.2025, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, si dhe dy herë konsultime me palën, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 4022/25 - ZSP- 2025 Datë: 19.09.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Gjakovë;
- Arkivit të Ministrisë.

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

Izedin BYTYQI

